



UNIVERSITETI "UKSHIN HOTI" PRIZREN
UNIVERSITY "UKSHIN HOTI" PRIZREN

FAKULTETI I SHKENCAVE TË JETËS DHE MJEDISIT
DEKANATI

Rruga e Shkronjave Nr. 1, 20000 Prizren -Kosovë; Tel:+381 (0) 29- 232 140; Homepage: www.uni-prizren.com

Për/Za/To:	Këshillin e Fakultetit të Shkencave të Jetës dhe Mjedisit (FSHJM) Prof. Asoc. Dr. Isuf Lushi, kryesues i Këshillit të Fakultetit
Nga/Od/From:	Komisioni vlerësues për shqyrtimin e aplikacioneve të kandidatëve për pranimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në FSHJM Prof. Ass. Dr. Albana Milaimi – kryetare Prof. Ass. Dr. Kushtrim Braha – anëtar Prof. Ass. Dr. Ylli Kortoçi – anëtar
Datë/a:	09.11.2021
Tema/Subjekat/Subject:	Propozimet për pranimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Fakultetin të Shkencave të Jetës dhe Mjedisit

**RAPORT PËR ANGAZHIM TË BASHKËPUNËTORËVE TË JASHTËM PËR
LIGJËRATA DHE USHTRIME PËR VITIN AKADEMIK 2021/2022, SEMESTRI
DIMËROR**

Bazuar në nenin 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, dhe nenin 7 të rregullores për procedurat vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve në Universitetin "Ukshin Hoti" si dhe bazuar në konkursin plotësues të shpallur nga Senati i Universitetit, sipas referencës nr. prot. 01-307, të datës 28.10.2021 si dhe në kuptim të vendimit të Këshillit të Fakultetit të Shkencave të Jetës dhe Mjedisit, sipas referencës nr. prot. 01-97, të datës 27.09.2021 mbi formimin e komisionit për vlerësimin e kandidatëve aplikues, komisioni i propozon Këshillin e Fakultetit të Shkencave të Jetës dhe Mjedisit këta kandidatë:

1. Një mësimdhënës për lëndën mësimore: Fizikë dhe meteorologji (3 orë L)

Kandidatët e paraqitur sipas radhës së aplikimit (Nr. protokollit) janë:

1. MSc. Avni Morina

Dokumentet relevante:

- Rregullorja e procedurave vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin "Ukshin Hoti" Prizren me nr. prot. 01-17 e datës 28.01.2020, neni 7, pika 2.1; 4 dhe 8 për procedurat vlerësuese.
- Kriteret e konkursit (dokumentacioni i kompletuar, publikimet shkencore, përvoja në fushën përkatëse, konflikti i interesit etj.)

Tabela e përzgjedhjes së bashkëpunëtorëve të jashtëm për ligjërues sipas Rregullores nr. 01-17 e datës 28.01.2020

Nr.	Kandidati/ja	Neni 7. pika 2.1			Neni 7. pika 4	Neni 7. pika 10	Publikimet shkencore?	Angazhimi sipas Rregullores Nr. 01-17 e datës 28.01.2020
		Grada shkencore Dr. sc.?	Dr. sc. adekuat?	Thirrje akademike në ndonjë Universitet publik?	Përvoja në UPZ?	Konflikt interesi, afërsia familjare?		
1.	Avni Morina	/	/	JO	JO	JO	PO	Mbetet në diskrecion të Këshillit të FSHJM dhe Senatit

Kandidati në lëndën mësimore: Fizikë dhe meteorologji (**MSc. Avni Morina**) nuk i plotëson në kriteret e parapara në konkurs sa i përket mungesës së gradës akademike të doktorit të shkencave. Ndonëse kandidati aplikant deklaron se e ka mbrojtur temën e diplomës së doktoratës në drejtimin e Fizikës mjekësore në Fakultetin e Inxhinierisë Fizike në Universitetin e Tiranës (UT), në dosjen e kandidatit nuk është prezantuar diploma dhe nostrifikimi i diplomës së studimeve të doktoratës. Kandidati aplikant ka prezantuar dëshmi të përvojës së punës akademike në Universitetin e Prishtinës (UP). Në mungesë të kandidatëve të tjerë aplikant në përputhje me nenin 7, pika 6.1 të Rregullores Nr. 01-17 e datës 28.01.2020, komisioni i drejtohet Këshillit të FSHJM dhe Senatit, që të vendos për këtë pikë të konkursit në lidhje me angazhimin e mësimdhënësit të lëndës mësimore: Fizikë dhe meteorologji.

2. Një mësimdhënës për lëndën mësimore: GIS për analizën e peisazhit (3 orë L dhe 2 orë U)

Kandidatët e paraqitur sipas radhës së aplikimit (Nr. protokollit) janë:

1. Prof. Ass. Dr. Ferim Gashi

Dokumentet relevante:

- Rregullorja e procedurave vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin “Ukshin Hoti” Prizren me nr. prot. 01-17 e datës 28.01.2020, neni 7, pika 2.1; 4 dhe 8 për procedurat vlerësuese.
- Kriteret e konkursit (dokumentacioni i kompletuar, publikimet shkencore, përvoja në fushën përkatëse, konflikti i interesit etj.)

Tabela e përzgjedhjes së bashkëpunëtorëve të jashtëm për ligjërues sipas Rregullores nr. 01-17 e datës 28.01.2020

Nr.	Kandidati/ja	Neni 7. pika 2.1			Neni 7. pika 4	Neni 7. pika 10	Publikimet shkencore?	Angazhimi sipas Rregullores Nr. 01-17 e datës 28.01.2020
		Grada shkencore Dr. sc.?	Dr. sc. adekuat?	Thirrje akademike në ndonjë Universitet publik?	Përvoja në UPZ?	Konflikt interesi, afërsia familjare?		
1.	Ferim Gashi	PO	PO	PO	PO	JO	PO	Propozohet për angazhim

Kandidati i propozuar në lëndën mësimore GIS për analizën e peisazhit (**Prof. Ass. Dr. Ferim Gashi**) i plotëson në tërësi kriteret e parapara në konkurs. I njëjti është profesor me thirrje akademike Prof. Ass. Dr. në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina” dhe ka performancë të mirë të mëhershme në FSHJM.

3. Një mësimdhënës për lëndën mësimore: Sociologji rurale (2 orë L dhe 4 orë U)

Kandidatët e paraqitur sipas radhës së aplikimit (Nr. protokollit) janë:

1. MSc. Agon Baxhaku
2. Dr. Sc. Simir Krasniqi

Dokumentet relevante:

- a) Rregullorja e procedurave vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin "Ukshin Hoti" Prizren me nr. prot. 01-17 e datës 28.01.2020, neni 7, pika 2.1; 4 dhe 8 për procedurat vlerësuese.
- b) Kriteret e konkursit (dokumentacioni i kompletuar, publikimet shkencore, përvoja në fushën përkatëse, konflikti i interesit etj.)

Tabela e përzgjedhjes së bashkëpunëtorëve të jashtëm për ligjërues sipas Rregullore nr. 01-17 e datës 28.01.2020

Nr.	Kandidati/ja	Neni 7. pika 2.1			Neni 7. pika 4	Neni 7. pika 10	Publikimet shkencore?	Angazhimi sipas Rregullore Nr. 01-17 e datës 28.01.2020
		Grada shkencore Dr. sc.?	Dr. sc. adekuat?	Thirrje akademike në ndonjë Universitet publik?	Përvoja në UPZ?	Konflikt interesi, afërsia familjare?		
1.	Agon Baxhaku	/	/	JO	JO	JO	PO	Nuk propozohet për angazhim
2.	Simir Krasniqi	PO	JO	JO	JO	JO	PO	Nuk propozohet për angazhim

Kandidati aplikant **MSc. Agon Baxhaku** (Master i Sociologjisë) nuk ka diplomë të doktoratës (gradë shkencore Dr.sc.) prandaj i njëjti nuk i përmbushë kriteret e konkursit. Poashtu, edhe kandidati **Dr. Sc. Simir Krasniqi** (Doktor në fushën: Bujqësia dhe mjedisi, Drejtimi: Shkencat Mjedisore) nuk ka diplomë të fushës e cila përputhet me kurrikulën e lëndës: Sociologji rurale.

Shënim: Pas shqyrtimit të dokumentacionit, rezulton që kandidatët e lartshënuar (propozuar) i plotësojnë më së miri kriteret ligjore të parapara në konkurs. Gjatë përzgjedhjes së kandidatëve së lartcekur, kriteri kryesor për renditjen në listën e lartcekur ishte grada akademike dhe fusha specifike e studimeve.

Udhëzim Juridik: Kandidatët e pakënaqur kanë të drejtë ankese në komisionin për ankese në FSHJM, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e publikimit të vendimit të Këshillit të FSHJM-së (miratimit të këtij raporti).

Komisioni:

1. Prof. Ass. Dr. Albana Milaimi – kryetare _____

2. Prof. Ass. Dr. Kushtrim Braha – anëtar _____

3. Prof. Ass. Dr. Ylli Kortoçi – anëtar _____